1180. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega I, kutia 79, dosje nr. 68. Informacion mbi qëndrimin armiqësor të indonezianëve me banim në Shqipëri, 14 (katërmëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1181. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega I, kutia 79, dosje nr. 69. Korrespondencë në lidhje me personat që ndiqen si agjentë të zbulimeve të huaja, 31 (tridhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1182. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega I, kutia 79, dosje nr. 70. Disa përfundime për organizimin e punës në drejtim të të riatdhesuarve, 23 (njëzet e tre) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1183. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega I, kutia 79, dosje nr. 71. Informacion për bisedat e tregtarit kanadez K.G., mbi qëndrimet e PPSH-së ndaj revizionizmit modern, 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.

1184. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega II, kutia 79, dosje nr. 72. Detyrat funksionale të shefit të shtabit të batalionit për survejimin e përfaqësive diplomatike, 3 (tre) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1185. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega II, kutia 79, dosje nr. 73. Programi dhe detyrat vjetore të përgatitjes ushtarake – profesionale të survejtimit, 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1186. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega II, kutia 79, dosje nr. 74. Plani vjetor i ndërlidhjes së Degës së Dytë, 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1187. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega II, kutia 79, dosje nr. 75. Raport për punën e bërë për realizimin e detyrave nga survejimi, 22 (njëzet e dy) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1188. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega II, kutia 79, dosje nr. 76. Raport vjetor i degës për realizimin e detyrave, 58 (pesëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1189. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega II, kutia 79, dosje nr. 77. Raporti për sigurimin e selive, banesave dhe mjeteve të personelit të ambasadave, 10 (dhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1190. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega II, kutia 79, dosje nr. 78. Raport për marrjen, përpunimin dhe transmetimin e të dhënave e të metat përkatëse, 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1191. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega II, kutia 79, dosje nr. 79. Informacion mbi punëtorin operativ ilegal V.L., 4 (katër) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1192. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega II, kutia 79, dosje nr. 80. Informacion e të dhëna për veprimtarinë e zbulimit kinez, 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1193. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega II, kutia 79, dosje nr. 81. Studim për masat që duhen marrë në forcimin e disiplinës në punë, 7 (shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1194. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega II, kutia 79, dosje nr. 82. Informacion mbi komentet e diplomatëve të huaj në Tiranë, 141 (njëqind e dyzet e një) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1195. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega II, kutia 79, dosje nr. 83. Informacion mbi një ngjarje të ndodhur në sigurimin fizik të atashut tregtar egjiptian në Tiranë, 7 (shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1196. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega II, kutia 79, dosje nr. 84. Përgjithësim mbi fiksimin e dokumentin e veprimtarisë së selive të huaja diplomatike në Tiranë në vitet 1975 – 1978, 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1197. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega II, kutia 79, dosje nr. 85. Raport për përmirësimin e punës në drejtim të përfaqësive diplomatike të huaja, 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1198. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega II, kutia 79, dosje nr. 86. Plan masash në drejtim të diplomatëve që frekuentojnë hotelet “Dajti” e “Arbëria”, 6 (gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1199. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega III, kutia 80, dosje nr. 87. Program i përgatitjes profesionale dhe ushtarake të degës, 9 (nëntë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1200. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega III, kutia 80, dosje nr. 88. Porosi të ministrit dhënë Degës së Kundërzbulimit të Kufirit, gjatë vitit 1972. Shkresa është e vitit 1978, 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1201. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega III, kutia 80, dosje nr. 89. Urdhër i zëvendësministrit rreth shkaqeve që çuan në arratisjen në Greqi të shtetasve S.G., F.D. dhe A.M. Arratisja ndodhi më

- 30.10.1977 në Kakavijë, 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1202. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega III, kutia 80, dosje nr. 90. Raporti vjetor i degës, 50 (pesëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1203. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega III, kutia 80, dosje nr. 91. Raport i përbashkët i Drejtorisë së Parë dhe Drejtorisë së Kufirit për punën në kufi gjatë viteve 1974 – 1978, 8 (tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1204. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega III, kutia 80, dosje nr. 92. Përgjithësim mbi zbulimin dhe goditjen e një grupi armiqësor në flotën tregtare Durrës, 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1205. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega III, kutia 80, dosje nr. 93. Përgjithësim mbi zbulimin e “grupit” të H.B. në zonën e Prespës, 14 (katërmëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1206. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega III, kutia 80, dosje nr. 94. Letër udhëzuese dërguar degëve mbi dekonspirimin e 3 bashkëpunëtorëve, 4 (katër) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1207. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega III, kutia 80, dosje nr. 95. Informacione për shfaqje negative personelin ushtar e polic në reparte 303 Spaç dhe 5999 Korçë, 7 (shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1208. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega III, kutia 80, dosje nr. 97. Informacione mbi organizimin e punës agjenturore – operative në brigadën e ndjekjes në Shkodër, 9 (nëntë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1209. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega III, kutia 80, dosje nr. 98. Informacion dërguar kryeministrit mbi kriminalitetin në radhët e ushtarakëve, 8 (tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1210. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega III, kutia 80, dosje nr. 99. Korrespondencë me degët në rrethe për tërheqje në bashkëpunim, dalje dëshmitarë në procese, etj., 136 (njëqind e tridhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1211. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega IV, kutia 80, dosje nr. 100. Programi i punës profesionale speciale ushtarake, 10 (dhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1212. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega IV, kutia 80, dosje nr. 103. Mbi disa probleme të sektorit të evidencës operative, 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1213. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega IV, kutia 80, dosje nr. 104. Përfundime të nxjerra nga studimi i statistikave të përpunimeve dhe agjunkturës, 39 (tridhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1214. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega IV, kutia 80, dosje nr. 105. Pasqyrat vjetore të statistikave të agjunkturës e përpunimeve, 9 (nëntë) fletë, (mungon tabela në fletën 7. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1215. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega IV, kutia 80, dosje nr. 106. Propozime të bëra për ndryshimin në statistikat ekzistuese për agjunkturën e përpunimet, 4 (katër) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1216. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega IV, kutia 80, dosje nr. 107. Relacion mbi të meta të vërejtura në shkelje me rregullën e evidencës operative, 6 (gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1217. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega IV, kutia 80, dosje nr. 108. Procesverbale mbi asgjësim dosjesh formularë dhe të problemeve të centralizuara, 40 (dyzet) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1218. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega IV, kutia 80, dosje nr. 109. Procesverbale mbi asgjësim dosjesh formularë dhe të problemeve të centralizuara, 70 (shtatëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.

1219. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega IV, kutia 80, dosje nr. 110. Pasqyra e shpenzimeve agjenturiale – operative për vitin 1978, 3 (tre) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1220. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega IV, kutia 80, dosje nr. 111. Përgjithësim mbi shkeljen e normave të punës agjenturiale – operative me b.p. “Buna” në repartin 325 Tiranë dhe një shkelje në Librazhd, 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1221. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega IV, kutia 80, dosje nr. 112. Akte ndihme e kontrolli në degët e rretheve mbi shpenzimet e fondit të veçantë, 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1222. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega IV, kutia 80, dosje nr. 113. Lista e të dhëna mbi veprimet me agjenturën në degët e rretheve, 280 (dyqind e tetëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1223. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega IV, kutia 80, dosje nr. 114. Korrespondencë me degët mbi dinamikën e agjenturës, 217 (dyqind e shtatëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.
1224. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, dega IV, kutia 80, dosje nr. 115. Korrespondencë me hetuesinë mbi përdorjen e bashkëpunëtorëve si dëshmitarëve në gjyq, etj., 100 (njëqind) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit i dosjes është “sekret”.

KRYETARI I KDZH
Dr. Gentiana Sula

Vendim nr. 6, datë 26.02.2024 (i shkurtuar)

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, të kreut I, neni 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror””, komisioni i deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 06. 02. 2023, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, i ndryshuar me urdhrin nr. 56, datë 23.03.2023, me **vendimin nr. 6, datë 26.02.2024** si më poshtë:

Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkivi i Autoritetit, fondi dega Punëve të Brendshme Kukës, arka 3, dosje personale dhe pune nr. 2951 “Pushka”, në ngarkim të M.I., me 2 volume, në total 109 (njëqind e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1977-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
2. Arkivi i Autoritetit, fondi dega Punëve të Brendshme Kukës, arka 1, dosje personale dhe pune nr. 2954 “Drini”, në ngarkim të M.H., me 2 volume, në total 77 (shtatëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1977-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
3. Arkivi i Autoritetit, fondi dega Punëve të Brendshme Kukës, arka 2, dosje personale dhe pune nr. 1173 “Shullani”, në ngarkim të S. M., me 2 volume, në total 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1969-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
4. Arkivi i Autoritetit, fondi dega Punëve të Brendshme Kukës, arka 1, dosje personale dhe pune nr. 3338 “Kunora”, në ngarkim të I. U., me 2 volume, në total 81 (tetëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1980-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
5. Arkivi i Autoritetit, fondi dega Punëve të Brendshme Kukës, arka 1, dosje personale dhe pune nr. 4000 “Guri”, si dhe fashikull personal për të dënuar, me 3 volume, në ngarkim të I.M., në total 666 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1980-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.

6. Arkivi i Autoritetit, fondi dega Punëve të Brendshme Kukës, arka 3, dosje personale dhe pune nr. 1255 "Rezervuari", në ngarkim të G. M., me 2 volume, në total 193 (njëqind e nëntëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1971-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
7. Arkivi i Autoritetit, dega Punëve të Brendshme Kukës, kartel model 2, nr. 4164, pseudonimi "Valbona" në ngarkim të A.H., niveli i klasifikimit sekret, daton në vitet 1986.
8. Arkivi i Autoritetit, dega Punëve të Brendshme Kukës, kartel model 2, nr. 4567, pseudonimi "Shkolla", në ngarkim të R. B., niveli i klasifikimit sekret, daton në vitet 1989.
9. Arkivi i Autoritetit, dega Punëve të Brendshme Kukës, kartel model 2, nr. 4497, pseudonimi "Studenti", në ngarkim të S.A., 2 ekzemplarë, niveli i klasifikimit sekret, daton në vitet 1988.
10. Arkivi i Autoritetit, fondi dega Punëve të Brendshme Lezhë, arka 6, dosje pune nr. 2240 "Bredhi", në ngarkim të M. Ll., me 2 volume, në total 266 (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1983-1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
11. Arkivi i Autoritetit, fondi Drejtoria Punëve të Brendshme Tiranë, arka 24, dosje personale dhe pune nr. 18 "Stilografi", në ngarkim të A.M., me 2 volume, në total 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1973-1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
12. Arkivi i Autoritetit, fondi dega Punëve të Brendshme Lezhë, arka 5, dosje personale dhe pune nr. 1355 "Diamanti", në ngarkim të P.M., me 2 volume, në total 43 (dyzet e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1973-1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
13. Arkivi i Autoritetit, fondi dega Punëve të Brendshme Lezhë, arka 5, dosje pune dhe personale nr. 2595 "Telefoni", në ngarkim të Y.E., me 2 volume, në total 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1983-1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
14. Arkivi i Autoritetit, fondi dega Punëve të Brendshme Lezhë, arka 5, dosje personale dhe pune nr. 2714 "Lindja", në ngarkim të N.H., me 2 volume, në total 167 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1984-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
15. Arkivi i Autoritetit, fondi Drejtoria Punëve të Brendshme Tiranë, arka 23, dosje pune nr. 13747 "Letrari", në ngarkim të V.K., me 2 volume, në total 224 (dyqind e njëzet e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1985-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
16. Arkivi i Autoritetit, fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje përpunimi pa nr., në ngarkim të K. Ç. me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dokumenti daton në vitet 1990-1991. Niveli i klasifikimit i dosjes është "sekret".
17. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, kutia 117, dosje nr. 205, Informacione mbi disa probleme në dëmtimin e bojërave ngjyrosëse në kombinatin e tekstileve "Stalin" në Tiranë, 6 (gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1983. Niveli i klasifikimit i dosjes është "sekret".
18. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, kutia 133, dosje nr. 272, Informacion për disa probleme në industrinë e tekstileve, 9 (nëntë) fletë. Dosja daton në vitin 1984. Niveli i klasifikimit i dosjes është "sekret".
19. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, kutia 186, dosje nr. 200, Për disa probleme në kombinatin e tekstileve "Stalin", traverbangun Klos-Bulqizë, parkun e Laçit dhe uzinën e antibiotikëve, 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1987. Niveli i klasifikimit i dosjes është "sekret".
20. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, kutia 234, dosje nr. 388, Mbi zjarrin e rënë në magazinën e pambukut në magazinat e Kombinatit të Tekstileve "Stalin" Tiranë, 3 (tre) fletë. Dosja daton në vitin 1990. Niveli i klasifikimit i dosjes është "sekret".
21. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, kutia 234, dosje nr. 408, Informacione për disa probleme shqetësuese në sigurimin teknik dhe ecurinë normale të punës, si dhe në lidhje me kuadrin drejtues të Kombinatit të Tekstileve Tiranë, 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1990. Niveli i klasifikimit i dosjes është "sekret".
22. Arkivi i Autoritetit, fondi nr. 4, kutia 235, dosje nr. 503, Për disa parulla armiqësore në shkollën e mesme të tekstit Berat, 8 (tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1990-1991. Niveli i klasifikimit i dosjes është "sekret".

KRYETARI I KDZH
Dr. Gentiana Sula



KUJTESA

**DHE EDUKIMI
QYTETAR**

KATËR MARTIRËT E REVOLTËS SË SPAÇIT/ AIDSSH PËRGATIT FILLIMIN E PROCESIT TË RIKUPERIMIT TË TRUPAVE - 18 JANAR 2024, MIRDITË



AIDSSH zhvilloi disa takime koordinuese në qytetin e Mirditës, në zbatim të ligjit 45/2015, të ndryshuar, dhe bashkëpunimit për identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve, masave për ruajtjen e vendvarrimeve, si dhe nisjen e veprimeve konkrete në drejtim të procesit në vendvarrimin e dyshuar të katër martirëve të Revoltës së Spaçit: Skënder Daja, Pal Zefi, Dervish Bejko dhe Hajri Pashaj.

Takimi i parë i Kryetares së Autoritetit, Dr. Gentiana Sula, anëtarit z. Gjergj Marku dhe grupit të ekspertëve nisi me lëshimin e Dioqezës së Rrëshenit, Imzot Gjergj Meta, me të cilin u bisedua rreth përfundimeve të raportit hetimor-administrativ të AIDSSH-së për verifikimin mbi vendvarrimet e dyshuara dhe qartësimin e fatit të dyzet e katër të zhdukurve, të vrarë ose të vdekur gjatë vuajtjes së dënimit, në burgun e Spaçit, nismë e ndërmarrë në kuadër të përkujtimit të 50-vjetorit të revoltës së të burgosurve më 21-23 maj 1973.



Raporti cilëson në mënyrë të veçantë se vendi i identifikuar ku mund të jenë varrosur katër martirët e Revoltës së Spaçit ndodhet rreth 20 metër larg vendvarrimin të njohur të Shpalit. Në takim u kërkua mbështetja e kësaj dioqeze në veprimet e mëtejshme të kërkimit.

Takimet vijuan me kryetarin e Bashkisë së Mirditës, z. Albert Mëlyshi. Pas falënderimeve të rastit për bashkëpunimin dhe gatishmërinë në realizimin e hetimit administrativ, u fol për domosdoshmërisë në avancimin e procesit të kërkimit edhe gjetjes së eshtrave të martirëve të Revoltës së Spaçit, duke u fokusuar në nevojën për fillimin e gërmimeve në vendin e dyshuar si vendvarrimi i tyre.

Gjatë kësaj vizite që kishte në qendër marrjen e masave konkrete në drejtim të zbatimit të ligjit 45/2015, të ndryshuar, dhe bashkëpunimit për identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të të zhdukurve e të të ekzekutuarve, masave për ruajtjen e vendvarrimeve, Autoriteti zhvilloi takime pune edhe me drejtuesin e Komisarariatit të Policisë së Mirditës, z. Klodian Kondi, të cilit iu komunikuan rezultatet e hetimit 6-mujor administrativ ku



përcaktohen koordinatat e vendit të dyshuar si vendvarrim për katër martirët e Revoltës së Spaçit.

Drejtuesi i Komisarariatit të Policisë së Mirditës, z. Klodian Kondi shprehu gatishmërinë për nisjen e rrethimit të zonës dhe të gërmimit në bashkëpunim me Bashkinë e Mirditës dhe AIDSSH-në. Më pas ekipi i ekspertëve të AIDSSH-së vizitoi ish-Burgun e Spaçit dhe më pas vendvarrimin e dyshuar në Shpal, Mirditë.

Autoriteti vlerëson bashkëpunimin e deritanishëm me institucionet përgjegjëse dhe shpreh bindjen se bashkërisht do të vepohet më tej për të bërë të mundur që plaga e pambyllur e familjeve, të cilat janë në kërkim të qartësisë të fatit të familjarit, të vrarë pa gjyq apo ekzekutuar në kushte jonjerëzore, të mbyllet me gjetjen e tyre dhe nderimin që u takon, pranë familjeve.

DIALOGU LOKAL NË MIRDITË / TAKIME ME TË ISH-PËRNDJEKURIT POLITIKË TË ZONËS - 19 JANAR, MIRDITË



AIDSSH vijoi vizitën në Mirditë në vendet e kujtesës historike të ngritur me kontribut të banorëve të zonës në kujtim të burrave të Mirditës, të pushkatuar me akuzën për pjesëmarrje në të ashtuquajturat “banda të armatosura”, pjesë e rezistencës antikomuniste të zonës 1944-1954.

Me Shoqatën e të Persekutuarve dhe të Përndjekurve Politikë, Mirditë, nënkryetarin Viktor Deda, sekretaren Marjana Molla, dhe ish-të përndjekurit Anton Çupi, Zef

Gera, Alfred Shtinja u bisedua rreth domosdoshmërinë e vendosjes së një partneriteti me qëllim çeljen e dialogut për zonën e Mirditës, angazhimin e historianëve të zonës për studime të mëtejshme në arkivin e AIDSSH-së me qëllim ndërtimin e një pavijoni për ngjarje të viteve 1944-1991 në muzeun historik të qytetit dhe nisjen e aktiviteteve në kuadër të platformës “Të mësojmë mbi të shkuarën” me nxënësit e shkollave të qytetit dhe më gjerë.



PROGRAM I RI I AIDSSH-SË PËR MËSUESIT / KLUBI I LIBRIT – “MËSOJMË NGA E KALUARA” JANAR 2024, TIRANË

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) nisi Klubin i Librit me fokus “Mësojmë nga e kaluara”, në të cilin do të diskutohet rreth librave artistikë e historikë, etj. ku përshkruhen ngjarje që kaluan në heshtje gjatë regjimit diktatorial.



Programi i këtij Klubi synon të përfshijë në aktivitetin e leximit dhe të diskutimit mbi libra me tematikë nga ngjarje dhe personazhe, ekzistenca e të cilëve është mohuar nga letërsia e shkruar gjatë realizimit socialist, kur shteti kontrollonte narrativën e shkrimtarëve dhe shpërndante informacione të shtrembëruara për të ruajtur pushtetin.

Librat do të përzgjidhen nga bordi i Klubit i Librit, me përfaqësi nga AIDSSH, MAS dhe Qendra e Librit dhe Leximit, por lista do të mbetet e hapur për sugjerime nga anëtarë të klubit. Takimet e Klubit të Librit do të mbahen në qytete ku AIDSSH ka hapur Dialogët Lokalë si: Shkodër, Berat, Sarandë, Konispol, Delvinë, Mirditë, etj., por edhe në qytete të tjera ku ka universitete dhe AIDSSH synon të shtrijë bashkëpunimin me pushtetin vendor.

Materialet e dala nga Klubi i Librit do të jenë pjesë e platformës digjitale “Të mësojmë nga e kaluara ’44 - ’91 – Burime të arsimore të hapura”, e cila vjen në funksion të edukimit të të rinjve me njohjen e të vërtetave historike dhe veprimtarisë së zhvilluar nga ish-Sigurimi i Shtetit, pas Luftës së Dytë Botërore në vend.

NË PËRKUJTIM TË 27 JANARIT, DITËS NDËRKOMBËTARE TË HOLOKAUSTIT / KORÇA, THEMELON KLUBIN E LIBRIT “MËSOJMË NGA E KALUARA” - 25 JANAR 2024, KORÇË

Aktiviteti i parë i Klubit të Librit “Mësojmë nga e kaluara” nisi në qytetin e Korçës, vendi ku është themeluar shkolla e parë shqipe, ku të pranishëm në bibliotekën “Thimi Mitko” e qytetit ishin profesorë dhe studentë të Universitetit “Fan S. Noli”, mësues dhe nxënës të sistemit parauniversitar, historianë dhe anëtarë të Shoqatës së të Përndjekurve të zonës. Në takimin e parë të Klubit u diskutua mbi librin “Rrufeja në shtëpinë e mikpritësit”, të autorit Marçel Hila në përkujtim të 27 janarit, Ditës Ndërkombëtare të Holokaustit.



të shoqërisë që edhe nuk e kanë jetuar këtë kohë,” tha Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula e cila shtoi gjithashtu se: “Këto libra ne në Autoritet i hasim përditë dhe i kemi me admirim burime të informimit, burime të hyrjes në një temë që flet për një kohë kur libra me ngjarje të tilla nuk ekzistonin. Këto libra e kanë të vështirë rrugën për të kaluar tek publiku dhe sidomos tek brezat e rinj ku Autoriteti ka dhe mandat të përcaktuar me ligj për edukimin qytetar. Kemi menduar që përmes Klubit të Librit



të bëjmë bashkë letërsinë dhe historinë, të flasim për aspektin njerëzor të këtyre historive që janë shpesh herë personale e intime. I ftojme mësuesit e këtyre katër lëndëve që të gjykojnë vetë për këto libra dhe pse jo të përdorin mendimin kritik dhe t’i qasen dosjeve të ish-Sigurimit.”

Dr. Brunilda Çerraga, moderatore dhe përgjegjëse e programit, në AIDSSH tha se: “Ky klub do të vazhdojë rrugëtimin e tij edhe në qytete të tjera të vendit, ku ne synojmë të afrojmë sa më shumë mësues, nxënës dhe studentë”.

Gjatë diskutimeve të mbajtura, profesorë të katedrës së Historisë të Universitetit të Korçës, si Metin Venxha, Nuredin Nazarko, Arjan Ago dhe studenti Migel Dulellari trajtuan në fjalën e tyre, se si është realizuar ballafaqimi i të vërtetave historike në rrëfimin e autorit.



Dr. Metin Venxha veçoi disa fakte historike që lidhen me ndihmën që qeveria shqiptare e kohës i ka dhënë hebrenjve dhe fakti që këto merita ende nuk i njihen këtyre figurave në historiografinë komuniste. “Në klubin e Parisit, hebrenjtë flisnin që është një mbretëri e vogël në Ballkan me një Mbret shumë dashamirës që jep viza, Ahmet Zogun. Këtë cilësi gati ia kemi mohuar. Apo kur



personazhi spiunohet në shtëpinë e vet në Austri ku kishte jetuar 25 vjet ndërsa kurse hoxha i xhamisë së Kavajës, i jep mikpritje dhe shërbim ende pa i njohur mirë. Pra, tregon institucionin e besës dhe mikpritjes së shqiptarëve, që edhe pse ishte një periudhë e tmerrshme për Shqipërinë dhe të gjithë Evropën, përsëri ne nuk lëvizëm nga kultura jonë.”

Të pranishëm, miq të Klubit të Librit, si akademiku Shaban Sinani, i cili përgëzoi AIDSSH-në për krijimin e këtij klubi dhe për tematikën e zgjedhur, tha se historia shqiptare e shpëtimit të hebrenjve sot në Izrael është lëndë e veçantë mësimore. Ndërkohë, Simon Mirakaj, familjari i një prej personazheve të librit, Kol Bibë Mirakajt, foli për rolin kyç në shpëtimin e hebrenjve në Shqipëri.



“Në këtë libër ngjarjet mbështeten në fakte historike, dhe kjo e gjallëron tregimin dhe ngjall interes tek lexuesi. Në këtë libër secili nga personazhet që nga qeveritarët, përfaqësuesit e feve, qytetarëve, malësorë, i mbajtën anën mysafirit, i mbajtën besën thënë kjo bukur në shprehjen “Shtëpia është e mikut dhe e Zotit”, u shpreh z. Skënder Vrioni, anëtar i Autoritetit.

Autori Marçel Hila tregoi rreth dokumenteve dhe dëshmimeve që ka përdorur për të shkruar subjektin e këtij libri. Në libër takohen personazhe historikë, si: Kolë Bib Mirakaj, Eqerem bej Libohova, Ibrahim Biçakçiu, Lef Nosi, Mehdi Frashërin, e Padre Anton Harapit. Ky libër flet për histori të vërteta të mbrojtjes së familjeve hebreje në Shqipëri, për përpjekjet e drejtuesve të Shqipërisë, në atë kohë, për t’i mbrojtur ata, dhe që më vonë iu nënshtruan ndëshkimeve më të ashpra nga diktatura komuniste.

Sipas statistikave zyrtare, 3750 hebrenj janë strehuar dhe shpëtuar në Shqipëri gjatë pushtimit nazist. Hapja e dyerve për hebrenjtë u bë e mundur falë trashëgimisë historike dhe harmonisë fetare, por edhe Kodit të BESË-s, fjalës së dhënë dhe të mbajtur.

Pas Klubit të Librit, Kryetarja e Autoritetit zhvilloi një takim me Drejtoren e Bibliotekës së qytetit të Korçës, me të cilën u fol për bashkëpunime të mëtejshme dhe vendosjen e një fondi librash të Autoritetit në një stendë të veçantë për lexuesin e interesuar. Gjithashtu u diskutua që edhe librat e Klubit të Librit të jenë pjesë e kësaj biblioteke.

Klubi i Librit
Mësimi më i shkurort

DISKUTIM MBI LIBRIN:
Rrufeja në shtëpinë e mikpritësit

Autori: Marçel Hila

DT: 25.01.2024 ORA: 13:00
Biblioteka 'Miri Mitko'
Adresa: Bulevardi Republika, Korçë

NË KUADËR TË KLUBIT TË LIBRIT / AIDSSH DISKUTON GRABJANIN NGA RRËFIMI TEK DOSJET - 6 SHKURT 2024, TIRANË



Në kuadër të Klubit të Librit, punonjës të AIDSSH-së u mbledhën në bibliotekën “Musine Kokalari” të institucionit për të diskutuar mbi librin “Grabjani rrëzë kodrave” të shkrimtarit dhe piktorit Lekë Tasi, ish-i përndjekur politik. Të pranishmit vlerësuan tematikën e trajtuar në këtë roman dhe pasuruan me fakte dhe dëshmi. Ata gjithashtu diskutuan për rakordimin e punës me qëllim përgatitjen e materialeve ndihmëse për diskutimin e mëtejshëm të librit në takimin me mësues, pedagogë, studentë dhe historianë që do të mbahet gjatë muajit shkurt në Tiranë.

Takimi u drejtua nga shkrimtarja për fëmijë pranë AIDSSH, znj. Rovena Rozhani. Të pranishmit krahasuan disa fakte nga jeta në internim e autorit, dhe rrëfimet e tij në libër, të cilat mund të gjenden të provuara në dokumentet arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit.



Libri të njuh veçanërisht me kushtet sfillitëse që trajtoheshin të internuarit politikë, ndërsa autori trajton diversitetin krahinor dhe deri diku diferencimin klasor të të internuarëve që bëheshin bashkë në vuajtje dhe në realitetin mbyttës.

Lekë Tasi ishte 38 vjeç kur e pushuan nga puna si violinçelist, në Orkestrën e Radios dhe në Teatrin të Operas, në vitin 1967, për shkak të biografisë. I ati Koço Tasi shpallet kundërshtar i regjimit komunist, dhe dënohet me burg ndërsa xhaxhai i tij, Akile Tasi vdes në burgun e Burrelit pas 17 viteve burg. Dhjetë vjet më vonë familja tij, nëna, motra, ai bashkë me të vëllanë, internohen në kampin e punës në Grabjan të Lushnjës, prej viti 1975 deri në vitin 1990. Të gjitha kujtimet dhe përjetimet e jetës në këtë kamp ai i hedh në librin e tij, “Grabjani rrëzë kodrave”, trajtuar në formën e një ditari ku përshkruan me detaje mbi kushtet e jetesës, keqtrajtimit, shfrytëzimit, vuajtjes shpirtërore, fizike dhe psikologjike, duke treguar me detaje një realitet të hidhur dhe pak të njohur në ditët e sotme me skena, personazhe, histori nga fshati i internimit në vitet '70-'80.



KLUBI I LIBRIT NË KORÇË / “ODISEJA E PAFAJËSISË”, FATI I NJË DASHURIE NË DIKTATURË - 14 SHKURT 2024, KORÇË



Profesorë, studentë të historisë, letërsisë së Universitetit "Fan S. Noli", mësues të historisë, letërsisë dhe qytetarisë së arsimit parauniversitar, ekspertë të AIDSSH-së, diskutuan “Odiseja e Pafajësisë” në Klubin e Librit – “Mësojmë nga e kaluara”.

Të pranishëm ishin; shkrimtari, ish-i përndjekur politik, z. Ylber Merdani dhe mbesa e shkrimtarit, znj. Eva Pervizi, dëshmitare nga afër e jetës së xhaxhait të saj, Valentinit, personazhit që na mëson me historinë e tij se si dashuria triumfon edhe pas 47 viteve përndjekje dhe errësirë.

Libri sjell historinë e vërtetë të dashurisë midis Valentin Pervizit dhe të fejuarës së tij italiane Goricia Mamin të cilët lënë Italinë dhe mbërrijnë në Shkodër më 10 tetor 1944. Mësojnë se familja e Valentinit, djalit të Preng Pervizit, gjeneralit të ushtrisë mbretërore shqiptare është shpallur “armike e popullit”. Disa muaj më vonë në qytetin e Shkodrës do të fillonin arrestimet, burgosjet dhe pushkatimet e para. Në zallin e Kirit ekzekutoheshin me dhjetëra burra pa gjyq, e për të vijuar më pas dhe në lagjet e rrugicat e qytetit, të gjithë të ashtuquajtur “armiq të popullit”. Në këto kushte Gori pas shumë përpjekjeve u riatdhesua në Itali me besimin së shumë shpejt çifti do të ribashkohej. Për Valentin Pervizin, si dhe për të gjithë familjen e mbetur nis odiseja e burgjeve dhe internimeve dhe prej gjysmëshekulli ata mbetën larg njëri-tjetrit.



Valentini, pas rënies së regjimit, rigjeti Gorin, e cila ende e priste në Bolonja, në vitin 1991. Kaluan 8 vite së bashku dhe lanë si mësim dashurinë e tyre që i mbijetoi errësirës komuniste. Më 2017-ën kjo histori erdhi për publikun nga Lek Pervizi, vëllai i Valentinit, në librin “Odiseja e Pafajësisë”, ku me nota autobiografike, historia e familjes së gjeneralit të mirënjohur shkrihet me historinë e errët të Shqipërisë nga viti 1944 deri në vitin 1991.

Ky libër ishte në qendër të diskutimeve të Klubit të Librit me pjesëmarrjen e profesorëve dhe studentëve të Universitetit "Fan S. Noli", mësuesve të historisë dhe letërsisë, të arsimit parauniversitar të qytetit të Korçës, si dhe të ftuarve të nderit, z. Ylber Merdani dhe znj. Eva Pervizi, mbesa e autorit dhe personazhit kryesor.

Nën moderimin e drejtuesit Prof. Dr. Metin Venxha, drejtues i departamentit Histori-Gjeografi, Universiteti “Fan S. Noli”, dhe Dr. Brunilda Çërraga, AIDSSH, nisi diskutimi për librin, ku u përcoll



mesazhi që njohja e së kaluarës historike edhe nëpërmjet teksteve letrare, të shkruara si histori personale, është një mundësi e shtuar diturie për të rinjtë, mësuesit e nxënësit.

Dëshmitar i kohës, z. Ylber Merdani, “Qytetar nderi” i qytetit të Korçës, ish-i dënuar politik, pas përgëzimeve të rastit për nismën e Klubit të Librit, rrëfeu sakrificat e të burgosurve, dhe shfrytëzimin e njeriut nga njeriu, nën regjimin komunist. Ai vjen nga një familje ku katër breza



kanë jetuar nën persekutim dhe trauma. Si një i mbijetuar, ai vlerëson se të rinjtë duhet ta njohin të kaluarën që ajo të mos përsëritet.

Dr. Orjon Ago, historian dhe zv/dekan i Fakultetit të Filologjisë, universiteti "Fan S. Noli", bëri një krahasim të historisë së librit dhe fakteve historike, duke theksuar se ende historia ka nevojë për rishikime bazuar në dokumente dhe dëshmi të tilla që na vijnë nga të mbijetuarit. Ndërsa studiuesja e historisë në AIDSSH,

Enxhi Beka, në analizën e saj sipas këndvështrimit historik u shpreh se: "Romani nuk është vetëm odiseja e Valentin Pervizit në veçanti, apo e familjes së Pervizëve në tërësi, por simbolikisht e shumë individëve duke filluar që nga një shtetas i thjeshtë që ka jetuar në vitet e regjimit komunist, e që për regjimin për shumë arsye ishte i papëlqyeshëm e duke vijuar nga figurat apo familjet më erudite të Shqipërisë së asaj kohe që kaluan nëpër një odise vuajtjesh, internimesh, ekzekutimesh e ata që mundën, mbijetese."



Profesor i historisë, Dr. Nuredin Nazarko vlerësoi se: "Është e rëndësishme që e kaluara të mos mbulohet nga rrjedha e kohës. Populli që harron historinë është i paracaktuar që ta përsërisë atë. Ende sot ka studentë që nuk dinë saktësisht se çfarë është komunizmi si ideologji dhe çfarë e shkakton. Ideologjitë kanë fuqinë e ideve të mëdha. Komunizmi e përsosi ideologjinë dhe e ngriti në pedestal. Duhet të shohim të vërtetën lakuriqe."

"Në libër gjejmë personazhe dhe ngjarje të një kohe të panjohur për lexuesin e ri. Ky libër sjell konceptin e dashurisë së vërtetë, e cila nuk njihet kufij kohorë dhe gjeografik", - tha Leonora Hysolli, pedagoge e Departamentit të Letërsisë, Universiteti "Fan S. Noli". Një tjetër studiues, Brendon Salih e sheh librin në një qasje paradokse "ku "armiku" që etiketohet vjen nga një kulturë perëndimore për të kontribuar në vendin e vet, por që fatkeqësisht e ndjek një valë persekutimi në regjimin anti-njeri." Mbesa e Valentinit, Eva Pervizi, në emër të familjes përcolli disa nga ngjarjet e jetës së përbashkët me xhaxhain e saj në internim dhe falënderoi AIDSSH që këto histori që vijnë nga e kaluara i kthen në mësim për nxënësit dhe mësuesit e rinj.



33 - VJETORI I RRËZIMIT TË SHTATORES TË DIKTATORIT / TIRANË THEMELON KLUBIN E LIBRIT - "MËSOJMË NGA E KALUARA" - 20 SHKURT 2024, TIRANË



Një muaj pas themelimit të Klubit të Librit në Korçë, Klubi i Librit ndalon në Tiranë. AIDSSH zgjodhi simbolikën e 33-vjetorit të rrëzimit të shtatores të diktatorit, si një vijë ndarëse që shënoi fillimin e një epokë të re, pa internime, burgime të padrejta, dhunë, terror e izolim për të themeluar Klubin e Librit të Tiranës - "Mësojmë nga e kaluara".

Në këtë takim të parë mësues të historisë, letërsisë, qytetarisë nga gjimnazet dhe shkolla 9-vjeçare, studentë dhe pedagogë të universiteteve diskutuan për librin e Lekë Tasit, "Grabjani rrëzë kodrave". Në libër flitet për trajtimin çnjerëzor që u bëhej të internuarve politikë. Përveç analizës së ngjarjeve historike, sociale, ekonomike dhe politike, në këtë libër gjenden edhe shkëndijat e rebelimit të fshehtë ndaj diktaturës, sinjalet e para këto të ndryshimeve që do të kulmonin me rënien e shtatores të diktatorit në datën 20 shkurt 1991.



Në fjalën e saj, Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula u shpreh se: "Kujtimet janë çelësi për të zhblokuar dyert e së kaluarës. Ato na lejojnë të futemi në sfidat e atyre që kanë jetuar përpara nesh dhe të përjetojmë jetën e tyre ashtu siç ata e kanë jetuar. Ndaj edhe ne kemi zgjedhur librat memuar për t'ia përcjellë publikut, rrugën e historisë personale të qindra e mijëra të përndjekurve me qëllimin që çdonjëri nga ne të ndërtojë me sytë e mendjes dhe të shpirtit atë rrugë të vështirë që ata u detyruan të ndiqnin në regjimin komunist".

Aktiviteti vijoi me diskutimin e librit "Grabjani rrëzë kodrave" me pjesëmarrjen e mësuesve të historisë dhe letërsisë, qytetarisë të arsimit parauniversitar të kryeqytetit, nën moderimin e As.Prof. Dr. Fiona Thodri, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës dhe shkrimtares për fëmijë, Rovena Rrozhani, pranë AIDSSH-së.

Autori i romanit, z. Lekë Tasi, pasi foli për narrativën e përshkruar në librin e tij me nota biografike tha se: "Duhet theksuar çdo eksperiencë e vjetër, e mirë apo e keqe. Ne duhet të shkruajmë kujtimet. Kujtimet nuk është gjëja më e lehtë që mund të bëhen, por kur fillojnë të shkruhen, të mos pretendojmë të bëjnë letërsi, mjaftojnë të tregojmë faktet si ka ndodhur sepse kështu i shërbejmë memories. Të rinjve do t'u rekomandoja që ta lexonin këtë libër, sepse mund të formojnë ndonjë-farë njohje të së kaluarës siç ka qenë. Dhe sot jam i kënaqur që shoh librat në duart e lexuesve të rinj, të pranishëm. Kjo është një arritje."



"Libri është një instrument shumë i mirë për njohur dhe ditur, se dija dhe vërteta na çojnë përpara. Ndaj ky libër që po sjellim sot është një nga ata libra që i duhet mësuesit të historisë, letërsisë dhe qytetarisë. Njohja e së kaluarës historike edhe nëpërmjet teksteve letrare, të shkruara si histori personale, është një mundësi e shtuar diturie për të mësuar nga e kaluara." - u shpreh As.Prof. Dr. Fiona Thodri, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.

Pjesë e rëndësishme e aktivitetit ishte edhe lidhja e librit me arkivin me prezantimi i dokumenteve arkivore nga arkiva e AIDSSH-së, ku moderatorja Rovena Rrozhani, AIDSSH, krahasoi faktet e lexuara në libër dhe atyre të gjetura në dosjet hetimore-gjyqësore dhe dosje formulare të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, mbi përndjekjen që iu bë Lekë Tasit, xhaxhait të tij Akile, babait Koço, nënës Aleksandra, vëllait Napoleon dhe motrës Tefta.



“Është e rëndësishme të afrojmë lexuesit e rinj me autorë të cilët përmes letërsisë rrëfejnë anën e panjohur dhe të pajetuar të një periudhe të errët të historisë. Dokumentet, dëshmitë, faktet nga njëra anë dhe rrëfimi letrar nga ana tjetër janë kombinimi më i mirë për t’i pajisur të rinjtë me dije dhe kulturë demokratike.” tha znj. Rozhani në mbyllje të prezantimit.

Mësuesja e historisë në shkollën e mesme, të përgjithshme “Qemal Stafa” në Tiranë, Yllka Muka tregoi se arrin të gjejë forma për të përcjellë tek nxënësit e saj atë pjesë të historisë për të cilën nuk është shkruar gjerësisht në librat e shkollës. “Leximi i librit “Grabjani rrëzë kodrave” nga nxënësit i nxit ata të njohin të kaluarën dhe një burim i vlefshëm njohurie që tregon lidhjen e ngushtë mes historisë dhe letërsisë” - tha znj. Muka.



Mësues të letërsisë, historisë dhe qytetarisë, shprehen përpjekjet që ata bëjnë në shkolla për të shpjeguar atë pjesë të errët të historisë së diktaturës dhe e ftuan autorin, por edhe të tjerë dëshmitarë, ish-bashkëvuajtës të tij në internim, të pranishëm, të bëhen pjesë e bisedave shkollore mbi këtë temë.

Njohja me dokumentet e arkivit të AIDSSH-së, si dhe libra të tillë dëshmie janë një burim i pasur për të njohur të kaluarën dhe mësuar nga ajo, duke realizuar përcjelljen e historisë tek brezat e rinj.

Aktiviteti i Klubit të Librit synon pasurimin e Platformës “Mësojmë nga e kaluara 1944-1991-burime arsimore të hapura”, produkt i marrëveshjes dypalëshe MAS-AIDSSH, e cila ka në fokus njohjen e brezave të rinj, me ngjarje e vende, që dëshmojnë histori dhe realitete të viteve 1944-1991, dhe përfshirjen e tyre në vizita në vende të kujtesës historike.

Me shkrimtarin Lekë Tasi, ish-i përndjekur politik dhe të tjerë shkrimtarë që prekin ngjarje të patrajtuara të periudhës 1994-1991, Autoriteti po punon ngushtësisht që programi i KLUBIT I LIBRIT- "Mësojmë nga e kaluara" të shtrihet gjerësisht të mësuesit dhe nxënësit e arsimit parauniversitar.



BOTIME CILËSORE PËR TË KALUARËN HISTORIKE 1944-1991/AIDSSH DHE QKLL FIRMOSIN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI - 20 SHKURT 2024, TIRANË


Autoriteti për Informimin e dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) firmosi me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit (QKLL) marrëveshje bashkëpunimi me kontribut në arritjen e botimeve cilësore me theks në kaluarën historike 1944-1991.

“Librat që nuk janë bërë nga njerëz profesionistë të letrave, për shkak të rëndësisë shumë të madhe që kanë, nevojiten të pajisen me komentare, bibliografi, me referenca që të jenë sa më pranë sidomos mësuesve dhe nxënësve për të nxitur mendimin kritik. Nisim kështu një rrugë të përbashkët për të fuqizuar librat memuaristikë për t’i çuar ato sa më pranë shkollave, tek brezi i ri, i cili vjen në këtë botë me të panjohura.” - tha Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula pas nënshkrimit të marrëveshjes.

Ndërsa Drejtoresha e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, Alda Bardhyli e vlerësoi se: “Ky është një moment i rëndësishëm pasi çdo komunikim që ka të bëjë me kujtesën dhe aq më tepër me ata autorë, të cilët jetën dhe veprimtarinë e tyre më të madhe e kanë bërë gjatë burgjeve të komunizmit dhe përjetimit në to, është i duhuri. Njohja e veprave të tyre me lexuesin e ri është një mision dhe formë edukimi për ta njohur të shkuarën dhe për të mësuar prej saj” tha znj. Bardhyli duke shtuar se zbardhja e dokumenteve të Autoritetit, të cilat kanë një vlerë të madhe publike për ndriçimin e jetës së këtyre figurave do të jenë edhe pjesë e kësaj marrëveshje që do t’i shërbejë librit dhe leximit.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi vjen në kuadër të platformës “Mësojmë nga e shkuara 1944-1991-burime arsimore të hapura”, produkt i marrëveshjes dypalëshe MAS-AIDSSH, e cila ka në fokus njohjen e brezave të rinj, me ngjarje e vende, që dëshmojnë histori dhe realitete të viteve 1944-1991, dhe përfshirjen e tyre në vizita në vende të kujtesës historike.





**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Adresa: Njësia administrative nr. 4, Rruga e Dibrës
Garnizoni "Skënderbej", Tiranë
<http://www.autoritetidosjeve.gov.al>